


IN MEMORIAM



Ndërroi jetë veterani i arsimit Imer Jakupi


Më 19 maj të këtij viti, pas një sëmundje të shkurtë, në moshën 71 vjeçare, ndërroi jetë veterani i arsimit, Imer Jakupi nga fshati Gllumovë, Komuna e Sarajit. Ai kishte të mbaruar shkollimin për mësues, Akademinë pedagogjike - grupi historik gjeografi dhe Fakultetin filozofik në UT - grupi historik. Me shumë se katër dekada ai dha kontribut në edukimin dhe arsimin e gjeneratave, të cilët e kujtojnë me admirim. Gjatë karrierës së tij është vlerësuar si arsimtar, mësimdhënës dhe profesor në vullnet të mirë në edukimin dhe arsimin e gjeneratave. Gjatë punës, ka kontribuar në ngritjen e kualitetit në mësimdhënie. Rreth dy mandate ka qenë drejtor i shkollës në vendlindjen e tij në Gllumovë. Ai ka dhënë kontribut edhe në aktivitetet shoqërore për të mirën e bashkëqytetarëve të tij dhe më gjerë. Ka qenë kryetar në përbërjen e parë të Këshillit të Komunës Saraj. Nga viti 2016, me dinjitet i ka kryer punët sekretari i Shoqatës së pensionistëve Komuna Saraj. Shoqata e pensionistëve të Komunës së Sarajit, familjes Jakupi, i shpreh ngushëllime të thellë. (LP Saraj)

TAKIMI ME PENSIONISTIN DR. IVICA ZORIQ

VIRTUOZI EVROPIAN I MUZIKËS KORALE ASI I EVROPËS

Festivali "Teho", i cili mbahet tradicionalisht në qershor të çdo viti, duhej të mbahej për herë të 29-të këtë vit. Koronavirusi bëri punën e vet, duke e vonuar mbajtjen e festivalit deri në vjeshtë

Për të fituar çmime të larta evropiane në fushën e muzikës korale, siç është ajo më e larta në Norget të Belgjikës në vitin 2019 në konkurrencën e 100 koreve nga e gjithë Evropa, ose në Krakov të Polonisë në një festival të muzikës shpirtërore, gjithashtu më i larti, pastaj çmimet në Celje të Sllovenisë, Litomishël të Çekisë, si dhe në Holandë, Gjermani, Greqi dhe shumë të tjera, janë vetëm një konfirmim i një veprimtarie të vazhdueshme dhe të lartë të Ivica Zoriq, doktor i shkencave korale, pensionistit nga Tetova. Njohja e arritjeve të larta konfirmohet nga zgjedhja e tij si njeriu i parë në Forumin Ballkanik për kor, i cili përfshin shoqatat e korit nga Serbia, Bullgaria, Greqia, Kosova, Shqipëria, Turqia, Rumania dhe vendi ynë, i formuar në vitin 1998 në Tetovë, me iniciativën e këtij dirigjenti të njohur. Atij iu dha "Çmimi i tetorit" i Maqedonisë, Medalja "Shën Klimenti" i KOM - AO, "Çmimi i Sveti Savës", çmimi më i lartë komunal i qytetit të Tetovës, më pas çmimi "Kiril Pejcinoviq", "Simboli i Artit" i MM dhe shumë çmime të tjera. Ai është themeluesi i Korit të Fëmijëve "Lale", si dhe Korit të rinjve për femra "Menada" në Tetovë, me të cilin vizitoi mbi 20 vende të



Evropës, ku shfaqjet u shpërblyen me duartrokite të gjata. Ai u pensionua në vitin 2012 si profesor në Fakultetin e Arteve Muzikore në Shkup, ku u mbajt si pedagog deri në vitin 2018. Ivica Zoriq është një ndjekës i traditës shekullore korale në Tetovë, dhe është shfaqur menjëherë pas akademikut të ndjerë Todor Skalovski-Tetoc.

Në traditën korale të Tetovës zbulojmë se kori i parë u formua në vitin 1908, nga Petar Zdravev nga Tetova. Në vitin 1913 u formuan gjashtë kore të reja, dhe suksesin më të madh e arriti Kori Birski, i formuar në vitin 1922. Ne gjithashtu vërejmë ekzistencën e një kori rus, i cili përbëhej nga koristë - emigrantë nga Rusia, dhe më pas një numër të tjerë të koreve të meshkujve, të femrave, të përzier dhe atyre shpirtërore. Më 1947 u formua kori në gjuhën shqipe në kuadër të SHKA "Xheladin Zeqiri" dhe më pas në Shkollën e Mesme "Kiril Pejcinovic", të drejtuar nga Bekim Ramadani.

Në vitin 1950 u krijua Shkolla e muzikës Nizhe në Tetovë, e cila më vonë u shndërrua në shkollë fillore, ndërsa tani shkollë e mesme

me paralele në Strugë. Në atë shkollë, në 1972, Ivica Zoric u punësua si profesor i harmonikës dhe solfezhit, dhe ishte përgjegjës për udhëheqjen e korit dhe orkestrës në shkollë. Së bashku me disa pedagogë të tjerë të famshëm të muzikës në fushën e artit koral, në vitin 1973 u formua festivali "TEHO", i cili që nga viti 1997 ka fituar një karakter ndërkombëtar, dhe që nga viti 2013 në kuadër të festivalit "Teho" po zhvillohet gjithashtu një festival ndërkombëtar i muzikës shpirtërore ortodokse.

"Unë i kushtoj shumë kohë punës me korin "Lale" dhe "Menada", si dhe organizimit të festivalit "Teho", por e gjithë kjo është me mirëkuptimin dhe përkrahjen mbi të gjitha të gruastime, Vesna, e cila është mjekë me profesion dhe punon si profesore në Shkollën mjekësore në Tetovë. Në karrierën time, kohën më të gjatë prej 40 vjetëve, e kalova në Shkollën e muzikës, nga e cila isha drejtori i saj për 27 vjet. Me të vërtetë më plotëson puna mua, si profesor dhe si dirigjent. Imagjinoni sa është përhapur një rrjet i adhuruesve të muzikës jo vetëm në Tetovë por

edhe më gjerë. Një përfitim edhe më i madh është që pjesëmarrësit e korit të angazhohen në ngritjen e tyre kulturore, duke mos lejuar veten që t'i nënshtrohen veseve që janë karakteristike për këto vite. Për më tepër, korin në "Lale" dhe "Menada" jo vetëm që u njohën me më shumë se 20 vende dhe festivale në të gjithë Evropën, por gjithashtu përhapën miqësi, manifestuan shpirtin, njerëzimin dhe cilësinë e lartë të muzikës korale të Maqedonisë në vendet që vizitojmë. Jam krenar për atë që kam arritur në jetë, dhe tani po e plotësoj vërtet me ditë pensioni të plotësuara me punë në kore dhe rregullimin e oborrit të vilës në Setolenë e bukur", thotë Ivica Zoriq.

Festivali "Teho", i cili mbahet tradicionalisht në qershor të çdo viti, duhej të mbahej për herë të 29-të këtë vit. Koronavirusi bëri punën e vet, duke e vonuar mbajtjen e festivalit deri në vjeshtë. Adhuruesit në Tetovë dhe Maqedoni shpresojnë që "Teho" të mbahet dhe se Tetova dhe Leshoku do të jenë nikoqirë të disa koreve nga vendi dhe jashtë. Gojko Eftoski

STANDARDI I ANËTARËSISË ËSHTË GJITHMONË PRIORITET I LSHPM

Shkup, 17 qershor - Sipas Statutit të LSHPM dhe sipas Programit vjetor të cilin Lidhja e mban çdo vit të parin dhe një nga prioritetet më të rëndësishme të Lidhjes është përmirësimi i standardit të shfrytëzuesve të pensionit. Ky është prioritet edhe i shoqatave anëtare të Lidhjes. Për këtë shkak gjithmonë dhe gjithkund LSHPM kërkon përmirësimin e standardit pensional

të të gjitha njësive, kontakteve dhe niveleve, i njëjti të përmirësohet në mënyra të ndryshme. Në këtë domen përfshihet një numër i madh i beneficioneve për pensionistët si, ngritje të pensioneve, lirim nga participimi për mjekim spitalor, transport falas, rekreacion të banjës, zgjerim të listës së ilaçeve, furnizim të barnatoreve gjatë tërë muajit dhe të tjera. Kuptohet që

mund të jetë më mirë dhe standardi i pensionistëve të jetë më i mirë, por tjetër janë dëshirat, tjetër mundësitë.

Pakënaqësia të pensionistët në momentin është për shkak të mos marrjes së ndihmës ata me të ardhura më të ulëta gjatë pandemisë nga Korona virusi sepse pothuajse të gjithë pensionistët kush më pak kush më shumë në

shtetet e rrethit tonë morën ndihmë.

Lidhja e shoqatave të pensionistëve Maqedonia menjëherë në fillim reagoi përmes disa shkrimeve deri te Qeveria, përmes njoftimeve te mediat, por edhe në drejtime të mia si kryetare e LSHPM në më shumë televizione. Kishte shkrim me të dhëna krahasuese nga shtetet e rrethit tonë edhe në gazetën

"Penzioner plus", "Nova Makedonija" dhe "KOHA", por prapëse prapë në pakon e tretë të masave në lidhje me pandeminë, pensionistët shfrytëzues të pensionit më të ulët nuk ishin të përfshirë. LSHPM edhe më tej do të insistojë te Qeveria dhe deri të të gjitha institucionet në shtet që në pakot në vijim të përfshihen pensionistët. Stanka Trajkova (Kryetare e LSHPM)